


Siguri

Të shtëna me armë në një aheng në Podujevë – 59-vjeçari pranon se shtiu për gëzim familjar, Policia ia sekuestron armën



Sinjali.com

15 Gusht 2026 11:46



Të shtëna me armë janë raportuar mbrëmjen e së premtes gjatë një ahengu familjar në fshatin Bradash të Podujevës, ndërsa Policia ka identifikuar personin e dyshuar dhe ka sekuestruar armën, mëson Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se i dyshuari është **Bejtush Shabani 59-vjeçar**.

Rasti ka ndodhur më 14 gusht, rreth orës 23:30, kur Policia ka pranuar informatën se në një aheng në Bradash po kishte të shtëna me armë.

Njësia policore ka dalë në vendin e ngjarjes, ndërsa pas konsultimit me Prokurorin kujdestar është dhënë urdhër për kontroll.

Sipas informacioneve që ka siguruar Sinjali, Shabani ka pranuar se kishte shtënë me armë për shkak të një gëzimi familjar dhe më pas e ka dorëzuar vullnetarisht atë te zyrtarët policorë.

Në vendin e ngjarjes është sekuestruar një pistoletë me gaz “Zoraki 2918-T”, pesë fishekë, ndërsa janë gjetur edhe tri gëzhoja.

Policia ka kontrolluar edhe shtëpinë e të dyshuarit, me pëlqimin e tij dhe të familjarëve, por aty nuk është gjetur asgjë tjetër e dyshimtë.

59-vjeçari është intervistuar në praninë e avokatit mbrojtës.

Me urdhër të Prokurorit është iniciuar rast për “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe “Përdorim të armës apo mjetit të rrezikshëm”, ndërsa Shabani është liruar në procedurë të rregullt.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera